



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 tetor 2024
Nr. Ref.: RK 2555/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI263/23

Parashtrues

“Swiss Bau” Sh.p.k

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit [K.DH.SH.II.nr.233/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës Komerciale
të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë dhe Njoftimit [KMLC.nr.91/2023] të
31 korrikut 2023 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga “Swiss Bau” Sh.p.k me seli në Komunën e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) të cilën e përfaqëson avokati Visar Ostrozubi nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [K.DH.SH.II.nr.233/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë) dhe Njoftimin [KMLC.nr.91/2023] të 31 korrikut 2023 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.
3. Parashtruesi i kërkesës Aktvendimin [K.DH.SH.II.nr.233/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës Komerciale– Dhomat e Shkallës së Dytë e ka pranuar më 23 qershor 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [K.DH.SH.II.nr.233/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë dhe Njoftimit [KMLC.nr.91/2023] të 31 korrikut 2023 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 1 dhjetor 2023, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën ai e kishte dorëzuar në postë më 20 nëntor 2023.
7. Më 8 dhjetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [Nr.GjR.KI263/23] caktoi gjyqtarin Enver Peci, Gjyqtar raportuese dhe me vendimin [Nr.KSH.KI263/23] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzie Istrefi Peci, anëtarë.
8. Më 21 dhjetor 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Komerciale, dhe kërkoi që e njëjta ti dërgoj Gjykatës fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi Aktvendimin [K.DH.SH.II.nr.233/23], të 10 majit 2023 e Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë.
9. Më 10 janar 2024, Gjykata pranoi nga Gjykata Komerciale fletëkthesën me të cilën vërtetohet se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës Aktvendimin [K.DH.SH.II.nr.233/23], të 10 majit 2023 e Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë e ka pranuar më 23 qershor 2023.
10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç ‘rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

11. Më 25 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës dhe kompania “Teuta. Cos” Sh.P.K (në tekstin e mëtejme: kreditori) me seli në Prizren, si dy subjekte afariste kishin lidhur kontratë mbi shërbimin me të cilën ishin pajtuar që subjekti afarist “Teuta.Cos” Sh.P.K. të kryej shërbimet dhe atë aplikimin për leje ndërtimore, me të gjitha kërkesat administrative, si dhe të bëjë dokumentacionin teknik dhe projektin kryesor dhe revidimin për objektin individual shumë banesor. Gjithashtu palët kishin nënshkruar parakontratë për ndërtimin e objektit afaristo banesor në sipërfaqe të përgjithshme prej 1764 m². Kreditori pretendoi që parashtruesi i kërkesës nuk ia ka paguar borxhin në shumë prej 162,969.32€ (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e tridhjetë e dy cent).
13. Sipas shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës ka disa konteste me kreditorin, ku kreditori pretendon që parashtruesi i kërkesës nuk ia ka paguar borxhet e disa faturave, për të cilat janë zhvilluar disa procedura përmbartimore, mirëpo të cilat vetëm përmenden nga ana e parashtruesit por nuk janë kontestuar para Gjykatës.
14. Në një datë të pasaktësuar, kreditori kishte bërë propozim për përmbartim tek Përmbartuesi Privat E.H, (në tekstin e mëtejme: Përmbartuesi privat), ku kishte kërkuar që të aprovet propozimi për përmbartim ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të mos pagesës së pesë faturave të cilat së bashku kanë vlerën 162,969.32€ (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e tridhjetë e dy cent).
15. Më 24 maj 2021, Përmbartuesi privat përmes urdhrimit për përmbartim [P.nr.833/2021], aprovoi propozimin për përmbartim, përmes të cilit obligoi parashtruesin e kërkesës t'ia paguaj kreditorit shumë prej 162,969.32€ (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e tridhjetë e dy cent), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në shumë prej 109.74 euro (një qind e nëntë euro e shtatëdhjetë e katër centë).
16. Më 31 maj 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti prapësim pranë Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër urdhrimit përmbartimor [P.nr.833/2021] të 24 majit 2021 të Përmbartuesit privat. Duke pretenduar se faturat në të cilat është mbështetur përmbartimi, nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, pasi detyrimi i përcaktuar dhe i lejuar me propozim nuk ekziston, faturat nuk janë pranuar dhe vulosur nga ana e parashtruesit të kërkesës po ashtu, se të njëjtat janë të pabazuara në një punë juridike të vlefshme.
17. Më 15 qershor 2021, kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk i referohen kërkesave të nenit 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (në tekstin e mëtejme: LPP). Më tej, ka theksuar se dokumenti i besueshëm – fatura është e përshtatshme për përmbartim konform nenit 29 të LPP, si dhe se të gjitha faturat rrjedhin nga puna juridike përkatësisht kontratat dhe aneks kontratat e lidhura në mes të palëve në zyrat noteriale.
18. Më 14 shkurt 2022, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr.167/2021] refuzoi në tërësi si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi se urdhri përmbartimor [P.nr.833/2021] i Përmbartuesit privat mbetet në fuqi. Duke vlerësuar se faturat si dokumente të përmbartimit në këtë çështje juridike, përmbajnë të dhënat të cilat duhet t'i kenë dokumentet e besueshme të përmbartimit kështu duke plotësuar

kushtet ligjore të parapara në LPP, po ashtu se kreditori faturat në fjalë ia ka dorëzuar parashtruesit të kërkesës përmes postës në adresën e tij, të cilin dorëzim gjykata e njeh si të rregullt, duke u bazuar në nenin 103 par.1 të LPK-së. Më tej, në prapësimet e tij, parashtruesi i kërkesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vetme me të cilat do të provohej se dokumenti përmbarues nuk i plotëson kushtet për tu përmbaruar, e të cilat pretendime do ta pengonin zbatimin e përmbarimit në këtë çështje juridike.

19. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PPP.nr.167/2021] të 14 shkurtit 2022 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë këtë ankesë, ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje në shkallë të parë.
20. Më 1 gusht 2022, Gjykata Komerciale filloi punën, dhe lëndët e natyrës ekonomike kaluan në këtë Gjykatë për trajtim të metutjeshëm.
21. Më 10 maj 2023, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë përmes Aktvendimit [K.DH.SH.II.nr.233/23], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi aktvendimin [PPP.nr.167/2021] të 14 shkurtit 2022 të Gjykatës Themelore. Kjo gjykatë vlerësoi se gjykata e shkallës së parë përmes aktvendimit të ankimuar ka vendosur bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK dhe as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Më tej, theksoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij sipas nenit 69 par.4 të LPP, dhe se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.
22. Më 26 korrik 2023, parashtruesi i kërkesës pranë Zyrës së Kryeprokurorit ka paraqitur propozim për iniciimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kundër Aktvendimit [PPP.nr.167/2021] të datës 14 shkurt 2022 të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit [K.DH.SH.II.nr.233/23] të datës 10 maj 2023 të Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës material dhe shkeljes esenciale të dispozitave përkatëse të procedurës.
23. Më 31 korrik 2023, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes Njoftimit [KMLC.nr.91/2023], njoftoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e lejuar, duke u bazuar në nenin 14 par.3 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, pasi i njëjti thekson se, vendimet e Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë nuk mund të jenë objekt i atakimit me mjetin e jashtëzakonshëm juridik – Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë [K.DH.SH.II.nr.233/23] i datës 10 maj 2023 dhe Njoftimi [KMLC.nr.91/2023] i datës 31 korrik 2023 i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë përmes aktvendimit të kontestuar, i ka shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 të Kushtetutës, duke e diskriminuar, pasi i ka dhënë forcë ligjore një procedure e cila mbështetet në dokumente që nuk kanë bazë ligjore dhe nuk janë të nënshkruara nga

palët. Dhe në të njëjtën kohë Zyra e Kryeprokurorit të shtetit, ka diskriminuar parashtruesin e kërkesës duke i dhënë mbështetje ligjore aktvendimit të kontestuar.

26. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimi i kontestuar bie ndesh me qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale pasi që i njëjti thirret në aktvendimet [K.DH.SH.II.nr.1231/2022] të datës 10 janar 2023 dhe [KPPP.nr.777/2022] të datës 25 maj 2023 të Gjykatës Komerciale, duke theksuar se kjo e fundit në çështjet përmbartimore mes subjekteve të njëjta dhe të njëjtave metoda të përdorura nga kreditori, ka aprovuar ankesat dhe prapësimet e parashtruesit të kërkesës për shkak të mungesës së nënshkrimeve dhe bazës ligjore të lëshimit të faturave. Ndërsa në rastin konkret ka vendosur ndryshe duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimi i kontestuar i mohon të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, pasi qëndrimi juridik i Gjykatës Komerciale dhe praktikat e saj tregojnë se faturat e panëshkruara nga të dy subjektet, nuk paraqesin bazë ligjore për një procedurë të rregullt përmbartimore pasi konsiderohet se të njëjtat nuk plotësojnë kushtet ligjore për tu trajtuar si dokumente të besueshme, bazuar në nenin 27, 29 dhe 71 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (në tekstin e mëtejme: LPP).

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*
- [...]

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARTIMORE

Neni 68 Mjetet e jashtëzakonshme juridike

1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbartimore.
2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbartueshëm për përmbartimin me dhunë.

LIGJI NR. 08/L-015 PËR GJYKATËN KOMERCIALE

Neni 14 Mjetet e Jashtëzakonshme Juridike

3. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk lejohen për kontestet që trajtohen nga Gjykata Komerciale.

Vlerësimi i Pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
30. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”
31. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridik (shih, rastin e Gjykatës KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe KI35/18, parashtrues *“Bayerische Versicherungsverband”*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).
32. Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [K.DH.SH.II.nr.233/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë në lidhje me Njoftimin [KMLC.nr.91/2023] e 31 korrikut 2023 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

33. Gjykata në vazhdim i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

34. Gjykata shqyrton gjithashtu nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafët (1) (b) dhe (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

Rregulli 34 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar;

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe

[...].”

35. Megjithatë, bazuar në nenin 49 (Afatet) të Ligjit, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse kërkesa e tanishme është dorëzuar brenda afatit ligjor katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton rregullin i afatit katër-mujor është autonom dhe duhet kuptuar dhe aplikuar bazuar në faktet e secilit rast veç e veç për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për të paraqitur kërkesën para Gjykatës. Gjykata thekson se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajve, të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës, i shërben sigurisë juridike dhe siguron që çështjet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe parandalon autoritetet dhe personat e tjerë të afektuar që të mos mbahen në një gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI61/23](#), me

parashtrues, *Hedie Bylykbashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 majit 2023, paragrafi 33; KI24/23, me parashtrues, *Sami Nuredini*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 prillit 2023, paragrafi 21; dhe rastin e GJEDNJ-së, Lekić kundër Sllovenisë, kërkesat nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08 Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 65). Ky rregull gjithashtu i jep kohë parashtruesit potencial nëse do të paraqes një kërkesë në Gjykatë, dhe, nëse po, të vendosë për argumentet specifike që do i paraqes si dhe rrjedhën e fakteve, pasi që me kalimin e kohës bëhet i vështirë shqyrtimi i çështjeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës (shih, rastin e Gjykatës KI115/20, me parashtrues *Muharrem Rama*, Aktvendim për papranueshmëri, 3 nëntorit 2021, paragrafët 55 dhe 56; dhe rastin e GEDNJ-së, Sabri Güneş kundër Turqisë, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafët 52 dhe 55).

37. Afati katër (4) mujor fillon të rrjedhë nga dita e vendimit të fundit në kuadër të procesit të shterimit të mjeteve juridike (shih, rastin e Gjykatës, KI59/18, me parashtrues *Strahinja Spasić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 27 mars 2019, paragrafi 51; dhe rastin e GJEDNJ-së, Chapman kundër Belgjikës, kërkesa nr.39619/06, Vendim, i 5 marsit 2013, paragrafi 34). Në këtë kuptim, Gjykata thekson se kur parashtruesit i njihet e drejta për të pranuar kopjen e vendimit përfundimtar të gjykatave të rregullta, afati katër (4) mujor fillon të rrjedhë nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, pa marrë parasysh nëse vendimi është shpallur gojarisht ndaj parashtruesit të kërkesës. Ky kriter është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
38. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht e cila ka theksuar se nuk kërkohet shterimi i mjeteve juridike diskrecionale, apo mjeteve juridike që nuk janë drejtpërdrejtë në dispozicion të parashtruesve dhe që varen nga ushtrimi i diskrecionit nga ndërmjetësi. Sipas GJEDNJ-së, shterimi i mjeteve juridike dhe periudha katër (4) mujore janë të ndërlidhura ngushtë. Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, më tej thekson se afati katër (4) mujor fillon të rrjedhë nga dita kur parashtruesi ka pranuar vendimin e mjetit të fundit efektiv juridik (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës KI143/19, me parashtrues *Agim Thaqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2020, paragrafi 42; dhe KI111/22, me parashtrues *Bechtel Enka GP.O.P.*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 janarit 2023, paragrafi 44; dhe rastin e GJEDNJ-së, Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32567/06, Vendim i 17 shkurtit 2009).
39. Në këtë aspekt, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret Njoftimi [KMLC.nr.91/2023] 31 korrikut 2023 i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ishte mjet efektiv lidhur me pretendimet e parashtruesit për shkelje kushtetuese. Përgjigja në këtë pyetje, do të jetë vendimtare për vlerësimin nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është paraqitur brenda afatit katër (4) mujor.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në rastin konkret, procedura ndaj parashtruesit të kërkesës e zhvilluar para gjykatave të rregullta në lidhje me ligjshmërinë e Urdhrit përmbarrimor [P.nr.833/2021] dhe çështjen e përmbarrimit të faturave kontestuese ishte zhvilluar para dy instancave gjyqësore, Gjykatës Themelore dhe Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, që kishte rezultuar me nxjerrjen e Aktvendimit [K.DH.SH.II.nr.233/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë.
41. Sipas nenit 68 (Mjetet e jashtëzakonshme juridike) të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore parashihet se "nuk lejohen revizioni dhe përsëritja e procedurës ne

procedurën përmbaremore". Andaj, parashtruesi i kërkesës nuk kishte mjet juridik në dispozicion, që mund të përdorte "*personalisht*" për të sfiduar Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, para Gjykatës Supreme.

42. Megjithatë, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale– Dhomat e shkallës së dytë, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me propozimin që kjo e fundit të paraqesë në emër të parashtruesit të kërkesës, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme, kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se kjo kërkesë është plotësisht diskrecionale për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
43. Në kontekst të çështjes së parë, Gjykata, në parim, ka theksuar që mjeti juridik i propozimit për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në procedurë civile përmes Prokurorit të Shtetit, nuk është drejtpërdrejtë i qasshëm sepse është në diskrecionin e Prokurorit të Shtetit të ngritë një kërkesë të tillë ose jo në Gjykatën Supreme. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (shih, rastin e GJENDJ-së *Lepojić kundër Serbisë*, nr. 13909/05, Aktgjykim i 6 nëntorit 2007, dhe *Stojanovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 1431/03, Aktgjykim i 22 tetorit 2009), kjo e fundit kishte shpallur kërkesat e papranueshme si të pasafatshme, në rastet kur të njëjtat ishin paraqitur në Gjykatë pas vendimmarrjes së Prokurorit të Shtetit lidhur me refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke sqaruar, ndër tjerash, që (i) pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga gjykatat e rregullta, asgjë nuk i kishte ndaluar parashtruesit përkatës që të parashtronjë kërkesë në Gjykatë dhe se (ii) duke marrë parasysh që mjeti përkatës juridik nuk është drejtpërdrejtë i qasshëm dhe është në diskrecion të Prokurorit të Shtetit, për qëllime të llogaritjes së afatit, "vendim përfundimtar" është vendimi përkatës i Gjykatës së Apelit (shih, në mënyrë të ngjashme edhe rastet e Gjykatës *KI143/19*, me parashtrues Agim Thaqi, cituar më lart, paragrafët 40-44; *KI174/20*, me parashtrues DE-KO Sh.p.k, Aktvendimi për papranueshmëri i 25 shkurtit 2021, paragrafët 32-51; *KI234/21*, me parashtrues N.P.N "Çlirimi", Aktvendim për Papranueshmëri i 8 qershorit 2022, paragrafët 42-56; *KI111/22*, me parashtrues Bechtel Enka GP.O.P, cituar më lart, paragrafët 34-45).
44. Megjithatë, praktika gjyqësore e Gjykatës, njeh edhe raste në të cilat është vlerësuar kushtetutshmëria e njoftimeve të Prokurorit të Shtetit, përmes të cilave nuk është pranuar kërkesa e palëve për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në dobi të tyre dhe janë shtjelluar rrethanat kur njoftimet e tilla të Prokurorit të Shtetit, përjashtimisht, mund të i nënshtrohen vlerësimit të Gjykatës (shih, rastin e Gjykatës *KI42/18*, parashtruese Asija Muslija, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, përmes të cilit ishin vlerësuar pretendimet e parashtrueses për shkelje kushtetuese ndaj Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, mbështetur edhe në rastin e GJEDNJ-së *Gorou kundër Greqisë* (Nr. 2), kërkesa nr.12686/03, Aktgjykim i 20 marsit 2009.)
45. Megjithatë, rasti i lartcekur, *KI42/18*, dallon nga rasti konkret. Në këtë kontest, Gjykata rikujton se në rastin e lartcekur, *KI42/18*, parashtruesja e kërkesës kishte kontestuar specifikisht Njoftimin KMLC nr. 09/2018 të Prokurorit të Shtetit, të 2 marsit 2018, duke argumentuar se si ky Njoftim kishte shkelur të drejtat e saj kushtetuese, që ndërlidheshin, mes tjerash, edhe me mungesën e arsytimit të pretenduar të Njoftimit të kontestuar të Prokurorit të Shtetit. Ndërsa lidhur me Aktvendimit AC. nr. 3538/2017 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 8 dhjetorit 2017, që po ashtu ishte kontestuar në rastin *KI42/18*, si pretendim kryesor ishte mos vërtetimi i faktit nga Gjykata e Apelit se parashtruesja e kërkesës nuk e kishte nënshkruar Kontratën për Hipotekën të 2 dhjetorit 2011. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës së rastit *KI42/18*, lidhur me Aktvendimin AC. nr. 3538/2017 të Gjykatës së Apelit ndaras nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit, ishte paraqitur në Gjykatë po ashtu brenda afatit të paraparë me Ligj dhe Rregullore të punës.

46. Ndërsa, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet pretendime specifike që kanë të bëjnë me arsyet e dhëna nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe se si Njoftimi i kësaj të fundit për të mos paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme kishte cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës. Pretendimet e parashtruesit në kërkesën e tanishme ndërlidhen me pretendimet se *“Gjykata Komerciale i ka dhënë forcë ligjore një procedure e cila mbështetet në dokumente që nuk kanë bazë ligjore dhe nuk janë të nënshkruara nga palët”*.
47. Gjykata vëren se këto pretendime ishin shqyrtuar nga Gjykata Komerciale– Dhomat e shkalles së dytë dhe jo nga Zyra e Prokurorit të Shtetit. Kjo e fundit, në fakt, kishte vendosur vetëm nëse janë plotësuar kushtet ligjore që të paraqitet një kërkesë e tillë në Gjykatën Supreme.
48. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se në Njoftimin [KMLC.nr.91/2023] të 31 korrikut 2023, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit informoi parashtruesin e kërkesës se ishte refuzuar propozimi i tij për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.167/2021] të 14 shkurtit 2022 dhe Aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë [K.DH.SH.II.nr.233/23] të 10 majit 2023, pasi konsideroi se nuk ishte e lejuar një gjë e tillë sepse sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale përkatësisht sipas dispozitës së nenit 14 par.3 *“Përjashtimisht nga neni 1 i këtij neni, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk lejohen për kontestet që trajtohen nga Gjykata Komerciale”*.
49. Gjykata rikujton se, në rastin konkret, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë përmes Prokurorit të Shtetit, përveç që është në diskrecionin e këtij të fundit, do të mund të ngritët nga Prokurori Shtetit vetëm nëse plotësohen kushtet e caktuara ligjore. Gjithashtu, pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë më mënyrën se si Gjykata Themelore dhe ajo Komerciale kanë zbatuar ligjin kur kanë vendosur lidhur me ligjshmërinë e Urdhrit të përmbarimit, dhe statusin ligjor të faturave të kontestuara. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet pretendime specifike lidhur me Njoftimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, por paraqet para Gjykatës të njëjtat pretendime që i paraqet ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komerciale– Dhoma e shkalles së dytë [K.DH.SH.II.nr. 233/23], pretendime, të cilat Zyra e Kryeprokurorit nuk ka pasur juridiksion t’i adresojë sepse ajo vetëm ka kompetencë të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme dhe jo të vlerësojë shkeljet ligjore të bëra nga Gjykata Komerciale. Andaj, lidhur me këto pretendime, në rastin e parashtruesit të kërkesës, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë [K.DH.SH.II.nr. 233/23] të 10 majit 2023, asgjë nuk e ka ndaluar atë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.
50. Andaj, Gjykata vlerëson se *“vendim i fundit”*, sipas nenit 49 të Ligjit, lidhur me procedurat që ndërlidhen me faturat e kontestuara për të cilat ishte lëshuar Urdhri përmbarimor, konsiderohet Aktvendimi [K.DH.SH.II.nr. 233/23] i 10 majit 2023 i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.167/21] të 14 shkurtit 2022. Në këtë kontekst, Gjykata, më tej duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë, në përputhje me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës.
51. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se Aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë [K.DH.SH.II.nr. 233/23] ishte nxjerrë më 10 maj 2023. Në fletëkthesën e dërguar nga Gjykata Komerciale, me kërkesë të gjykatës, e cila dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale –Dhoma e shkallës së dytë, rezulton që data e pranimit të tij, të jetë 23 qershor 2023. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se koha në mes të pranimit të Aktvendimit dhe të datës së dorëzimit

të kërkesës së tij në postë, më 20 nëntor 2023, ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh.

52. Si pasojë, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktvendimin [K.DH.SH.II.nr.233/23] të 10 majit 2023 e Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
53. Andaj, mbi bazën e arsyetimeve të mësipërme, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës, më 25 shtator 2024 njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues


Enver Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka Nimani



The seal is circular with a blue border. The outer ring contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top and 'REPUBLIC OF KOSOVO' at the bottom. The inner ring contains 'GJYKATA KUSHTETUESE' at the top and 'CONSTITUTIONAL COURT' at the bottom. In the center is a figure of a woman holding a scale and a sword, representing justice.